



# **FLETORJA ZYRTARE**

## **E**

# **REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

**Nr.46**

**2005**

**14 qershor**

### **P Ë R M B A J T J A**

		Faqe
Ligj nr.9418 datë 20.5.2005	Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë .....	1645
Ligj nr.9419 datë 20.5.2005	Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë	1652
Ligj nr.9420 datë 20.5.2005	Për faljen e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore të papaguara .....	1669

**LIGJ**  
**Nr. 9418, datë 20.5.2005**

**PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË  
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është t'u garantojë ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe anëtarëve të familjeve të tyre përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", kur e ndërpresin karrierën, sipas ligjit nr.9171, datë 22.1.2004 "Për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

**Neni 2**  
**Përfituesit**

Përfitojnë sipas këtij ligji ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, oficer, nënoficer, student ushtarak dhe kursant për nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist, ushtar i shërbimit të detyrueshëm, ushtarak në rezervë/lirim/pension të plotë pleqërie dhe anëtarët e familjeve të tyre.

**Neni 3**  
**Vjetërsia në shërbim**

1. Vjetërsia në shërbim si ushtarak aktiv, për efekt të përfitimit nga ky ligj, llogaritet nga data e titullimit oficer, nënoficer, ushtar me pagesë/profesionist në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ndërsa për ushtarakët, të cilët kanë kryer stazhin për oficer, nga data e fillimit të stazhit.

2. Në vjetërsinë në shërbimin aktiv përfshihen:

a) koha e shërbimit të përhershëm (oficer, nënoficer, ushtar profesionist/me pagesë);  
b) koha e ndërprerjes së karrierës, për shkak të një urdhri a vendimi të padrejtë, të deklaruar me vendim gjykatë;

c) koha e plotë e vuajtjes së dënimit ose internimit për motive politike, pas titullimit si ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm, kur përfitohet sipas ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë" dhe kur kanë jo më pak se 5 vjet në strukturat e Forcave të Armatosura;

ç) koha gjatë së cilës ushtaraku ka shërbyer në strukturat e Ministrisë së Rendit Publik apo të Shërbimit Informativ të Shtetit.

3. Për efekt të llogaritjes së shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, koha e shërbimit në funksionet organike, me specifikë të veçantë shërbimi e vështirësie, llogaritet me 1,5-fishin.

Këto funksione organike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 4 **Financimi**

1. Përfitimet nga ky ligj financohen nga Buxheti i Shtetit dhe kontribuesit. Përfitimet nga ky ligj garantohen nga Buxheti i Shtetit. Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve, që rrjedhin nga ky ligj, me përjashtim të atyre të përcaktuara në nenet 10, 11 e 12 bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Përballimi i shpenzimeve të përcaktuara në nenet 10, 11 e 12 bëhet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Mënyra e llogaritjes dhe e pagimit të përfitimeve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë paguajnë kontribut shtesë, mbi atë të përcaktuar në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në masën 2 për qind të pagës referuese.

Pjesa që do të paguajë Buxheti i Shtetit është sa diferenca ndërmjet shpenzimeve për zbatimin e këtij ligji me të ardhurat, që mbliidhen nga kontributet që derdhen ushtarakët e Forcave të Armatosura.

Kontributet paguhen çdo muaj në fondin e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura. Afati i derdhjes është jo më vonë se fundi i muajit pasardhës.

Shpenzimet për administrimin e skemës nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore përballohen nga Buxheti i Shtetit.

#### Neni 5 **Mostatimi i përfitimeve**

Përfitimet nga ky ligj nuk taten.

#### KREU II **FUSHA E MBROJTJES**

#### Neni 6 **Llojet e përfitimeve suplementare dhe kushtet e përfitimit**

Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe familjeve të tyre u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për:

- a) paaftësi të përkohshme në punë e shërbim;
- b) parandalim për sëmundje;
- c) pagesë kalimtare, kur nxirren në lirim/rezervë;
- ç) pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi;
- d) pension suplementar, mbi pensionin e plotë të pleqërisë;
- dh) pension suplementar invaliditeti;
- e) pension suplementar invaliditeti për ushtarakët, që për shkak të detyrës bëhen plotësisht të paaftë;
- ë) pension suplementar familjar;
- f) pension suplementar familjar për ushtarakët, që për shkak të detyrës humbasin jetën;
- g) pagesë suplementare në rast vdekjeje.

Neni 7  
**Kushtet për përfitim**

E drejta e përfitimeve suplementare për ushtarakun, sipas këtij ligji, varet nga vitet e shërbimit në Forcat e Armatosura dhe nga moshja e paga referuese, me shtesat që ka përfituar.

Neni 8  
**Paga referuese**

1. Paga referuese, për efekt të përfitimeve nga ky ligj, përbëhet nga paga bazë mujore për gradë, sipas viteve të shërbimit, së bashku me shtesat, që përfiton ushtaraku i së njëjtës gradë në çastin e lindjes së të drejtës së përfitimit.

2. Për ushtarakun, që ka dalë në rezervë ose në lirim, para apo pas datës së shtrirjes së efekteve financiare të këtij ligji dhe e drejta për të përfituar i lind pas kësaj date, paga referuese për efekt të përfitimeve nga ky ligj përbëhet nga paga bazë, së bashku me shtesat që ka ushtaraku aktiv, në po atë funksion ose gradë, në çastin që i lind e drejta për të përfituar.

3. Për studentët e shkollave të larta ushtarake, paga referuese për efekt përfitimi është paga e gradës më të ulët të oficerit, ndërsa për kursantët për nënoficerë paga referuese është paga më e ulët e gradës së nënoficerit.

4. Kur funksioni ose grada, që kishte përfituesi nuk është më, Ministri i Mbrojtjes, me urdhër, bën njësimin e tyre me ato funksione apo grada që janë në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës për përfitim.

**KREU III**  
**PËRFITIMET SUPLEMENTARE**

Neni 9  
**Kushtet e përfitimit suplementar për paaftësi të përkohshme në punë**

Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm, për kohën që, për arsye shëndetësore, bëhet i paaftë për punë, merr përfitime suplementare.

Neni 10  
**Masa e përfitimit suplementar për paaftësi të përkohshme në punë**

Masa e përfitimit suplementar për paaftësi të përkohshme në punë llogaritet mbi pagën mesatare ditore neto të muajit të fundit kalendarik të shërbimit:

- a) 20 për qind nga dita e pesëmbëdhjetë e paaftësisë e në vazhdim;
- b) 10 për qind për periudhën e shtrimit në spital, kur ka persona në ngarkim.

Kur paaftësia e përkohshme zgjat deri në 14 ditë, ushtaraku përfiton pagën e plotë neto të muajit të fundit kalendarik të shërbimit.

Neni 11  
**Parandalimi për sëmundje**

Ushtaraku, në varësi të situatave operationale, sipas përcaktimit të bërë nga komisioni mjekësor ushtarak, pranë Spitalit Universitar Qendror Ushtarak, gëzon të drejtën e parandalimit për sëmundje.

Ministri i Mbrojtjes, me udhëzim përcakton rastet, procedurat dhe kriteret përkatëse për zbatimin e këtij neni.

## Neni 12 Pagesa kalimtare

1. Ushtaraku, që pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxirret në rezervë apo lirim dhe ka mbi pesë vjet shërbim në Forcat e Armatosura, merr shpërblim në masën e dy pagave bazë për gradë, sipas viteve të shërbimit, si shpërblim të menjëhershëm dhe pas këtij shpërblimi merr pagesë kalimtare, në masën 50 për qind të pagesës që ka përfituar në çastin e daljes në rezervë apo lirim, për dy vjet.

2. Në rast punësimi gjatë kësaj periudhe, masa e pagesës kalimtare është deri në kompensimin e pagës, mbi të cilën është llogaritur kjo pagesë.

3. Periudha e trajtimit me pagesë kalimtare, për efekt të zbatimit të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, njihet si periudhë sigurimi. Kontributi për këto kategori përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet mbi bazën e pagës referuese, mbi të cilën është llogaritur pagesa kalimtare, por, në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të indeksuar me koeficientët e indeksit të pensioneve.

## Neni 13 Kushtet e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

Ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm, pavarësisht nga koha e daljes në rezervë/lirim, deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, kur plotësojnë vjetërsinë e shërbimit si ushtarak, në masën 12 vjet për femrat dhe 15 vjet për meshkujt dhe kanë mbushur moshën 44 vjeç femrat dhe 47 vjeç meshkujt.

## Neni 14 Masa e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi

1. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi është 50 për qind e pagës referuese.

2. Për çdo vit tjetër të vjetërsisë në shërbim, mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit shtohet me 2 për qind të pagës referuese.

3. Masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e madhe se katërfishi i pensionit bazë, sipas përcaktimit të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

4. Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet kur ushtaraku përfitues rikthehet në shërbimin aktiv.

5. Periudha, për të cilën ushtaraku përfiton pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni të plotë pleqërie, sipas pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributi për këto kategori përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet mbi bazën e pagës referuese, mbi të cilën është llogaritur pensioni i parakohshëm, por, në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të indeksuar me koeficientët e indeksimit të pensioneve.

6. Periudha 1.7.1992 deri 31.12.1998, për ushtarakët e dalë në reformë njihet periudhë sigurimi për efekt të pensionit të plotë të pleqërisë. Kontributet për këtë periudhë derdhen nga Buxheti i Shtetit, në bazë të pagës referuese nga çasti që ka lindur kjo e drejtë.

Mënyra, kushtet dhe kriteret e zbatimit të kësaj pike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Për ushtarakët, të cilëve u ka lindur e drejta e përfitimit të pensionit të parakohshëm para datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, niveli i masës së përfitimit të llogaritur vendoset në kufijtë e parashikuar në këtë nen.

#### Neni 15

### **Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar të pleqërisë për ushtarakët**

Ushtaraku i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur ka plotësuar kushtet për pension të plotë pleqërie, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfiton pension suplementar pleqërie, si ushtarak.

#### Neni 16

### **Masa e përfitimit të pensionit suplementar të pleqërisë për ushtarakët**

Pensioni suplementar i pleqërisë llogaritet në masën 40 për qind të pensionit të plotë të pleqërisë, kur ushtaraku ka vjetërsi shërbimi 12 vjet për femrat dhe 15 vjet për meshkujt.

Për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit mbi përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit suplementar të pleqërisë shtohet me 2 për qind të pensionit të plotë të pleqërisë.

Pensioni suplementar, në çdo rast, nuk duhet të jetë më i madh se 60 për qind të pensionit të pleqërisë.

Ushtaraku që ka vjetërsi shërbimi më pak sesa përcakton ky nen, përfiton pension suplementar në masën 2 për qind të pensionit të plotë të pleqërisë, për çdo vit shërbimi në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 17

### **Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar të invaliditetit**

Ushtaraku i shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përfiton pension invaliditeti, të plotë a të pjesshëm, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfiton pension suplementar invaliditeti, si ushtarak.

#### Neni 18

### **Masa e përfitimit të pensionit suplementar të invaliditetit**

Pensioni suplementar i invaliditetit llogaritet 2 për qind për çdo vit shërbimi në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbi pensionin që merr përfituesi, por jo më shumë se 50 për qind të pensionit të invaliditetit.

Periudha, për të cilën ushtaraku përfiton pension invaliditeti, njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni të plotë pleqërie. Kontributi për këto kategori përballohet nga Buxheti i Shtetit dhe derdhet mbi bazën e pagës referuese për gradë, funksion që ka pasur ushtaraku në çastin e nxjerrjes në rezervë/lirim, por në çdo rast, brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale, të indeksuar me koeficientët e indeksimit të pensioneve.

#### Neni 19

### **Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar të invaliditetit për ushtarin e shërbimit të detyrueshëm, studentin ushtarak ose kursantin për nënoficer**

Ushtari i shërbimit të detyrueshëm, studenti ushtarak ose kursanti për nënoficer, i cili për shkak të detyrës ose gjatë saj pëson dëmtime trupore apo mendore dhe përfiton pension të plotë apo të pjesshëm invaliditeti, përfiton edhe pension suplementar.

Neni 20

**Masa e përfitimit të pensionit suplementar të invaliditetit për ushtarin e shërbimit të detyrueshëm, studentin ushtarak ose kursantin për nënoficer**

Masa e përfitimit të pensionit suplementar të invaliditetit për ushtarin e shërbimit të detyrueshëm, studentin ushtarak ose kursantin për nënoficer është në masën 20 për qind të pagës referuese të gradës “nëntetar”.

Neni 21

**Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar familjar**

Personat, që janë në ngarkim të ushtarakut të shërbimit aktiv, në rezervë ose lirim, që vdes apo ka vdekur, dhe që përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, marrin pension suplementar familjar.

Neni 22

**Masa e përfitimit të pensionit suplementar familjar**

Masa e përfitimit të pensionit suplementar familjar llogaritet në 50 për qind për bashkëshortin/en e ve dhe 25 për qind për çdo jetim, prind dhe pjesëtar tjetër të familjes në ngarkim, me kufi maksimal shumë e plotë deri në 100 për qind të pensionit suplementar, që kishte ose i takonte të merrte të ndjerit, sipas këtij ligji.

Neni 23

**Kushtet e përfitimit të pensionit suplementar familjar për ushtarakët që, për shkak të detyrës apo gjatë saj, humbasin jetën**

Pjesëtarët e familjes në ngarkim të ushtarakut, i cili për shkak të detyrës apo gjatë saj, humbet jetën, dhe që përfitojnë pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë pension suplementar familjar.

Neni 24

**Masa e përfitimit të pensionit suplementar familjar për ushtarakët që, për shkak të detyrës apo gjatë saj, humbasin jetën**

Masa e përfitimit të pensionit suplementar familjar për ushtarakët që, për shkak të detyrës apo gjatë saj, humbasin jetën, llogaritet në vlerën 100 për qind të pagës referuese, shtesë mbi pensionin familjar.

Neni 25

**Kushtet për përfitimin e pagesës suplementare në rast vdekjeje të ushtarakut në rezervë/lirim**

Në rast vdekjeje të ushtarakut në rezervë/lirim, i cili trajtohet me pagesë kalimtare apo pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, familja e tij përfiton pagesë suplementare në formë ndihme, vetëm një herë.

Neni 26

**Masa e përfitimit të pagesës suplementare në rast vdekjetë ushtarakut në rezervë/lirim**

Masa e pagesës në rast vdekjeje të ushtarakut në rezervë/lirim është e barabartë me masën e trefshit të pensionit bazë mujor, në shkallë vendi, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe jepet nga Ministria e Mbrojtjes për ushtarakun që trajtohej me pagesë kalimtare ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për ushtarakun që trajtohej me pension të parakohshëm.

KREU IV

**DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE**

Neni 27

**Indeksi**

Përfitimet suplementare të pensioneve dhe të pagesës kalimtare indeksohen sipas indeksimit të pensioneve, të përcaktuar në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 28

**Mospërjashtimi nga përfitimet e përcaktuara nga ligje të tjera**

1. Ky ligj nuk përjashton përfitimet që jepen me dispozita të tjera ligjore.
2. Ushtarakët, të cilët nga ligje të tjera gëzojnë përfitime të veçanta mbi pensionin e pleqërisë, kanë të drejtë të zgjedhin ndërmjet trajtimit, sipas këtij ligji apo ligjeve të tjera.

Neni 29

**Pensioni suplementar për ish-ushtarakët**

1. Ish-ushtaraku i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përfiton pension pleqërie, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfiton pension suplementar si ushtarak.
2. Masa e pensionit suplementar është e njëjtë me masën e pensionit të llogaritur në nenin 16 të këtij ligji.

Neni 30

**Përjashtimi nga përfitimi**

Nga ky ligj nuk përfitojnë ushtarakët e nxjerrë në lirim për shkak se janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim, për krime të kryera me dashje.

Neni 31

**E drejta e pensionit**

1. E drejta e përfitimeve nga ky ligj nuk parashkruhet. Personit, që kërkon përfitimet jo më vonë se 1 vit nga data kur i lind kjo e drejtë, përfitimi i paguhet nga data e lindjes së të drejtës. Në raste të tjera përfitimi paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për përfitim.
2. Përfitimet e njohura, por të patërhequra, paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.
3. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë.
4. Personi, që ka përfituar të ardhura në mënyrë e me mjete të padrejta, si dhe kur nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër.

Neni 32  
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4 dhe 14 të këtij ligji.

Neni 33  
**Përfundimi nga zbatimi i ligjit nr.8087, datë 13.3.1996”Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar**

Ligji nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit”, i ndryshuar, dhe aktet e dala në zbatim të tij, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përfitojnë sipas këtij ligji.

Neni 34  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi në datën 1 janar 2006.

**Shpallur me dekretin nr.4623, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**LIGJ**  
**Nr. 9419, datë 20.5.2005**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË USHTARAKE**  
**TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Miratohet Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ligji nr.8930, datë 25.7.2002 "Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përgatisë aktet e nevojshme nënligjore, sipas përcaktimeve të bëra në Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4624, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES

STRATEGJIA USHTARAKE  
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
Maj 2005

PËRMBAJTJA

HYRJE	1654
MJEDISI I SIGURISË	1654
STRATEGJIA USHTARAKE	1655
A. Objektivat e Strategjisë Ushtarake	1655
B. Parimet e Strategjisë Ushtarake	1656
C. Koncepti i Strategjisë Ushtarake	1656
D. Karakteristikat e Forcave të Armatosura	1658
1. MISIONI I FORCAVE TË ARMATOSURA	1659
A. Në kohë paqeje	1659
B. Në kohë krizash	1659
C. Në kohë lufte	1660
2. KOMANDIMI DHE DREJTIMI NË FORCAT E ARMATOSURA	1660
3. ZHVILLIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA	1661
4. MISIONI, STRUKTURAT, DETYRAT E LLOJEVE TË FORCAVE DHE KOMANDAT MBËSHTETËSE	1661
A. Forcat Tokësore	1662
B. Forcat Detare	1663
C. Forcat Ajrore	1664
D. Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes	1665
E. Komanda e Mbështetjes Logjistike	1665
F. Njësitë dhe repartet autonome të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	1666
5. ELEMENTET BAZË TË MBROJTJES	1666
A. Burimet njerëzore	1666
B. Arsimimi dhe stërvitja në Forcat e Armatosura	1666
C. Infrastruktura	1667
D. Mbështetja financiare e Forcave të Armatosura	1668
PËRFUNDIME	1668

## HYRJE

Strategjia Ushtarake (SU) pasqyron mënyrat dhe metodat e realizimit nga Forcat e Armatosura (FA) të misioneve kryesore të përcaktuara në Kushtetutën dhe dokumentin e Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Shqipërisë.

Strategjia Ushtarake e Rishikuar është ripunim i dokumentit të Strategjisë Ushtarake, që është miratuar në korrik të vitit 2002 nga Kuvendi.

Ajo vlerëson mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë, përparimet e bëra në transformimin dhe ristrukturimin, Planin Afatgjatë të Zhvillimit, ndryshimet e nevojshme në përmbajtjen e misioneve, të detyrave, të strukturave, si dhe të koncepteve të zhvillimit të Forcave të Armatosura.

Strategjia Ushtarake përcakton rrugët dhe mënyrat e transformimit, të organizimit, të modernizimit dhe të stërvitjes së Forcave të Armatosura. Ajo synon rritjen e aftësive operacionale të FA-së për t'i bërë ato të afta për realizimin e misionit kushtetues, të ndërveprueshme dhe të dislokueshme në funksion të integritimit në strukturat e mbrojtjes kolektive euroatlantike.

Përmbushja e objektivit strategjik të antarësimit të Shqipërisë në NATO, që është synimi kryesor i kësaj strategjie, realizohet nëpërmjet zhvillimit të një force të aftë profesionalisht për të dhënë një kontribut pozitiv për sigurinë dhe stabilitetin e brendshëm dhe atë rajonal. Në të njëjtën kohë, ky objektiv është edhe pjesë e qëllimeve gjeostrategjike të NATO-s për forcimin e stabilitetit në rajonin juglindor.

### MJEDISI I SIGURISË

Shqipëria është pjesë e një mjedisi gjeostrategjik, që konsiderohet, nga njëra anë, si një mjedis ballkanik me të gjitha problemet historike të trashëguara të këtij rajoni dhe, nga ana tjetër, si një mjedis europian mbi të cilin vendet demokratike perëndimore ushtrojnë një ndikim pozitiv për stabilitetin, demokratizimin dhe integrimin e tij në të.

Prania e NATO-s në rajon është një faktor i rëndësishëm për garantimin e stabilitetit dhe nxitjen e bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit midis vendeve të tij. Gjithashtu, përpjekjet e të gjitha vendeve të rajonit tonë për t'u integruar në BE shtojnë edhe më shumë premisat për siguri, stabilitet, zhvillim ekonomik, prosperitet dhe paqe rajonale.

Pavarësisht nga përparimet e bëra këto vitet e fundit, rajoni i Europës Juglindore vazhdon të përballlet me sfidat, që rrjedhin nga faktorë historikë dhe nga brishtësia e demokracive ende në konsolidim të vendeve të rajonit.

### Situata dhe rreziqe të brendshme

Situata e brendshme e Shqipërisë paraqet, gjithashtu, mundësi zhvillimi të shoqëruara me rreziqe potenciale ndaj sigurisë së saj. Përparimet e dukshme në forcimin e institucioneve të shtetit ligjor, ekzistenca e një konsensusi të gjerë politik për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit, forcimi i kontrollit demokratik mbi Forcat e Armatosura, si dhe treguesit e rritjes së ekonomisë, ndikojnë pozitivisht në krijimin e një mjedisi të brendshëm të sigurt.

Në të njëjtën kohë, prania e dukurive të tilla, si trafiku ilegal i qenieve njerëzore, i armëve dhe i lëndëve narkotike, krimi i organizuar, terrorizmi, mbajtja e pakontrolluar e një pjese të armatimit të lehtë nga popullsia, fatkeqësitë e katastrofat në mjedis, dezinformimi i opinionit publik, emigracioni i pakontrolluar i njerëzve, ndikojnë në mjedisin e sigurisë së vendit tonë.

Në këto situata, Forcat e Armatosura luajnë një rol të rëndësishëm për parandalimin dhe luftën kundër dukurive të mësipërme, si dhe për dhënien e kontributit në ndihmë të strukturave të tjera të shtetit dhe të shoqërisë civile.

### Situata dhe rreziqe të jashtme

Gjendja aktuale e sigurisë në rajon dhe me gjerë, me probleme dhe zgjidhje ende të papërcaktuara, që burojnë më së shumti nga historia e tij komplekse, institucione shtetërore të brishta dhe zhvillim ekonomik të pamjaftueshëm, mund të shkaktojë që kriza në një shtet të ndikojë negativisht edhe në stabilitetin e sigurinë e shtetit ose të shteteve të tjera.

Në këtë kontekst, ringjallja e ndjenjave radikale etnike dhe prirjet për përdorimin e forcës ushtarake për realizimin e tyre mund të cenojnë edhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Rreziqet asimetrike përbëjnë sfidat më të mëdha të kohës për forcat ushtarake, si për të gjitha vendet e botës, edhe për vendin tonë. Këto kërcënime përfshijnë terrorizmin ndërkombëtar dhe/ose rajonal, krimin e organizuar, trafikun ilegal të të gjitha llojeve, ndotjen e mjedisit, përhapjen e armëve të dëmtimit në masë etj.

Në këto situata, Forcat e Armatosura kanë një rol të rëndësishëm në mbështetje të politikës së Republikës së Shqipërisë, duke dhënë kontribut pozitiv në krijimin e mirëbesimit rajonal. Ato përgatiten për të arritur aftësitë e nevojshme operacionale, të gatshme për të zgjidhur çdo situatë të krijuar në interes të sigurisë. Përfshirja e FA-së në strukturat e mbrojtjes kolektive, bashkëpunimi me vendet e NATO-s dhe ato partnere forcon më tej interesat e përbashkët për sigurinë e vendit, atë rajonale dhe globale.

Ky mjedis sigurie krijon mundësi të mira për transformimin e Forcave të Armatosura dhe përgatitjen e tyre për t'u integruar në strukturat ushtarake të NATO-s, si dhe rrit dukshëm domosdoshmërinë e gatishmërisë së tyre në përballimin e situatave, që mund të vënë në rrezik interesat kombëtarë të Republikës së Shqipërisë.

#### **STRATEGJIA USHTARAKE**

Strategjia Ushtarake përcakton mënyrat e veprimit të përbërësëve ushtarakë në mbështetje të Strategjisë së Sigurisë dhe të përmbushjes së misioneve të caktuara. Ajo u krijon kushte Forcave të Armatosura për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve të brendshme dhe të jashtme gjeostrategjike në mjedisin e sigurisë. Gjithashtu, siguron transformimin dhe modernizimin e FA-së, si bazë për objektivin kryesor të integritimit në strukturat e sigurisë kolektive.

#### **Tipari themelor i Strategjisë Ushtarake është karakteri i saj mbrojtës.**

Strategjia Ushtarake rishqyrton misionin, strukturat dhe konceptet operacionale të Forcave të Armatosura dhe jep orientime për një periudhë nga afatshkurtër në afatmesëm, në mbështetje të sigurisë së Republikës së Shqipërisë në kuadrin e sigurisë kolektive. Ajo vlerëson bashkëpunimin me fqinjët në rajon dhe kontributet e përbashkëta ndaj sigurisë, të realizuara nëpërmjet veprimtarive të tilla, si stërvitje shumëkombëshe dhe pjesëmarrja në operacione të mbështetjes së paqes.

Kjo strategji paraqet në vetvete një kontribut real për krijimin e mirëbesimit dhe të transparencës rajonale duke qenë e hapur në misionin e strukturën e FA-së, si dhe në zbatimin e marrëveshjeve për kontrollin e armëve.

Strategjia Ushtarake zhvillon aftësitë mbrojtëse të vendit në zbatim të objektivave të Politikës së Mbrojtjes për të:

- siguruar ruajtjen e sovranitetit, të pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të Republikës së Shqipërisë, mbrojtjen e popullsisë në kohë paqeje, krize dhe lufte, si dhe mbrojtjen e interesave kombëtarë;

- mbështetur objektivat e politikës së jashtme të Qeverisë, veçanërisht për integrimin e vendit në strukturat euroatlantike dhe promovimin e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare.

#### **A. Objektivat e Strategjisë Ushtarake**

- Zhvillimi i Forcave të Armatosura për të garantuar mbrojtjen e vendit.
- Rritja e aftësive operacionale të Forcave të Armatosura.
- Transformimi dhe modernizimi i Forcave të Armatosura.
  
- Rritja e aftësive për pjesëmarrje në operacione humanitare në raste fatkeqësish dhe në operacione të mbështetjes së paqes.
- Integrimi në strukturat kolektive të sigurisë europiane dhe euroatlantike.

**Synimi kryesor i këtyre objektivave është** transformimi dhe modernizimi i Forcave të Armatosura për të ndërtuar një forcë ushtarake të vogël në numër, me kërkesa për burime financiare dhe infrastrukturë të arsyeshme dhe të mundshme për t'u përballuar nga ekonomia e vendit. Kjo forcë të jetë operacionale dhe e motivuar.

#### **Integrimi në Bashkimin Europian dhe në strukturat e NATO-s**

Integrimi i vendit tonë në Bashkimin Europian (BE) dhe në NATO është një objektiv strategjik i Republikës së Shqipërisë.

Forcat e Armatosura kanë personelin e duhur, të përkushtuar, si dhe mbështetje logjistike në rritje, për t'u integruar plotësisht në Aleancë. Ato kanë plane e programe orientuese dhe trajnuese për zhvillimin e aftësive operacionale për të përshpejtuar procesin e anëtarësimit në NATO.

Përbushja e detyrimeve në kuadër të Programit të Partneritetit për Paqe (PfP), nëpërmjet realizimit të Planit të Veprimit për Anëtarësim (MAP), të Programit Individual të Partneritetit (IPP), pjesëmarrjes në Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit (PARP), kontributi në Operacionet e Mbështetjes së Paqes dhe të ndihmës humanitare në raste fatkeqësish, pjesëmarrja aktive në stërvitjet e përbashkëta, plotësimi i angazhimeve në kuadër të Kartës së Adriatik-3, si dhe roli aktiv në Brigadën Shumëkombëshe të Europës Juglindore (SEEBRIG), janë tregues të rëndësishëm të integrimit të Forcave të Armatosura.

#### **B. Parimet e Strategjisë Ushtarake**

##### **- Karakteri mbrojtës**

Strategjia Ushtarake ka një karakter mbrojtës në mbështetje të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe nuk konsideron si armik asnjë shtet.

##### **- Kontrolli civil demokratik mbi Forcat e Armatosura**

Forcat e Armatosura janë nën kontrollin civil demokratik, në komandim- drejtimin, në transformimin dhe zhvillimin tyre, në planifikimin e mbrojtjes dhe në burimet financiare.

##### **- Transparenca dhe besueshmëria e Forcave të Armatosura**

Strategjia Ushtarake mbështetet në parimet e aftësive të besueshme mbrojtëse, në kontekstin e bashkëpunimit dhe të kontributit ndaj strukturave të mbrojtjes kolektive euroatlantike.

##### **- Kryerja e operacioneve brenda Doktrinës së Bashkuar**

Zhvillimet e sotme strategjike dhe teknologjike në fushën e betejës kërkojnë që Forcat e Armatosura të kryejnë operacione brenda Doktrinës së Bashkuar, të ndërveprojnë me NATO-n dhe me forca të tjera aleate në kuadër koalicioni.

##### **- Mbështetja në traditat dhe vlerat luftarake të popullit shqiptar**

Strategjia Ushtarake mbështetet, gjithashtu, në traditat dhe vlerat luftarake të popullit shqiptar. Ato janë një përvojë e pasur në mbrojtje të lirisë së tij.

#### **C. Koncepti i Strategjisë Ushtarake**

Koncepti Strategjik i përdorimit të Forcave të Armatosura është:

Përballimi i sfidave, rreziqeve, kërcënimeve e konflikteve, që mund të na imponohen nëpërmjet përdorimit të Forcave të Reagimit të Shpejtë, rritjes shkallë-shkallë të mobilizimit të forcave të rezervës dhe në bashkëveprim me forcat e Aleancës në kuadrin e sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive europiane e euroatlantike.

Bashkëpunimi dhe partneriteti euroatlantik, si dhe me vendet e rajonit, janë rrugët më të mira për t'i përgatitur Forcat e Armatosura të ndërveprueshme dhe të gatshme për t'u integruar në një mjedis të sigurisë kolektive.

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë mbështetet në konceptin strategjik që Forcat e Armatosura të sigurojnë:

- Aftësi mbrojtëse të besueshme
- Përgjigje elastike dhe të zhdërvjellët ndaj situatave të ndryshme
- Bashkëveprim dhe partneritet

### **Aftësi mbrojtëse të besueshme**

Forcat e Armatosura sigurojnë një forcë profesionale dhe të integruar për t'iu përgjigjur efektivisht dhe në kohë kërcënimeve dhe sfidave, që mund të krijohen në mjedisin e sigurisë.

Vendosja e formacioneve të FA-së pranë rrugëve kryesore të komunikimit, porteve dhe aeroportëve, i përgjigjet nevojave dhe përgjegjësive për reagim të shpejtë në përmbushjen e misioneve në kohë paqeje, krize dhe luftime. Kjo lehtëson përdorimin e forcave të reagimit të shpejtë për pjesëmarrje të menjëhershme në rajonet e emergjencës dhe të fatkeqësive natyrore, ose në përgjigje të një krize që kërcënon territorin shqiptar.

### **Përgjigje elastike dhe të zhdërvjellët ndaj situatave të ndryshme**

Përgjigjja ndaj situatave fillon me marrjen e informacionit përmes zbulimit dhe vëzhgimit për veprimtaritë që kryhen në hapësirën territoriale (tokë, det, ajër) të Republikës së Shqipërisë. Bashkëveprimi midis llojeve të forcave dhe ato mbështetëse të FA-së është një kërkesë e vazhdueshme e Strategjisë Ushtarake për t'iu përgjigjur situatave të ndryshme. Reagimi në kohë dhe i kombinuar kërkon angazhimin dhe bashkëveprimin e konsoliduar të një sistemi modern C3 (komandim, drejtim, komunikim).

Identifikimi në kohë i një kërcënimi është domosdoshmëri dhe kërkesë për marrjen e masave parandaluese të menjëhershme. Realizimi i kësaj detyre bëhet nga forcat e specializuara, të cilat vendosen qysh në kohë paqeje për të siguruar monitorimin dhe zbulimin e krizave, kërcënimeve apo konflikteve.

Niveli i lartë i gatishmërisë së forcave speciale dhe i forcave të reagimit të shpejtë rrit shkallën e pjesëmarrjes së tyre në operacionet rajonale ose ndërkombëtare të mbështetjes së paqes, si dhe në operacione të tjera në kuadër koalicioni.

Në rast situatave të skajshme, kur integriteti i Republikës së Shqipërisë kërcënohet drejtpërdrejt, Forcat e Armatosura mobilizohen për përballimin e agresionit, në bashkëveprim me Aleancën dhe vendet partnere.

### **Bashkëveprimi dhe partneriteti**

Bashkëveprimi dhe partneriteti i Forcave të Armatosura me forcat e vendeve të NATO-s, mbi baza dypalëshe dhe rajonale me vendet partnere, janë parësore për realizimin e synimit të Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Shqipërisë për integrimin në strukturat kolektive euroatlantike.

Forcat e Armatosura do të jenë aktive në bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh, në veprimtaritë stërvitore ushtarake rajonale (përfshirë stërvitjet në interes të operacioneve të mbështetjes së paqes), si dhe do të kontribuojnë për ndërtimin e sigurisë, të mirëbesimit rajonal dhe të kontrollit të armatimit përmes transparencës në çështjet ushtarake. Për realizimin e të gjitha këtyre veprimtarive bashkëvepruese, thelbësore është vijimësia në zbatimin e reformave dhe modernizimi i FA-së, duke vënë theks të veçantë në ndëreveprueshmërinë dhe përmbushjen e standardeve të NATO-s.

### **D. Karakteristikat e Forcave të Armatosura**

Bazuar në këta objektiva, parime dhe në konceptin strategjik, synohet që Forcat e Armatosura të jenë:

- **Të bashkuara**
- **Të ndëreveprueshme**
- **Të gatshme për misionin**
- **Të zhdërvjellëta / të përshtatshme**
- **Të qëndrueshme**
- **Të afta për mbështetje ushtarake të strukturave civile**
- **Të organizuara për realizimin e detyrave**
- **Të afta për operacione speciale**
- **Të pajisura me aftësi të veçanta**

**Forcë e bashkuar.** Zhvillimi i aftësive të çdo lloj force të orientohet në mënyrë të tillë që secila prej tyre të kombinojë kapacitetet unike të shërbimit të vet në kuadrin e forcës së bashkuar, e aftë për të përmbushur misionet e caktuara.

**Forcë e ndërveprueshme.** Ndërveprueshmëria është themelore për të siguruar integrimin në operacionet e forcës së bashkuar dhe të kombinuar. Kjo arrihet përmes organizimit dhe stërvitjes së FA-së në përputhje me doktrinën dhe standardet e NATO-s, përmes pjesëmarrjes në stërvitjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, gjithnjë, sipas konceptit të zhvillimit të aftësive operacionale.

Në mënyrë të veçantë pjesëmarrja jonë në operacionet e mbështetjes së paqes është faktor i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve operacionale dhe ndërveprueshmërisë.

Forcat e Armatosura planizojnë e stërviten për zhvillimin e aftësive të ndërveprimit me strukturat e tjera të shtetit në raste krizash ose fatkeqësish.

**Të gatshme për mision.** Gatishmëria e lartë është themelore për një përgjigje të shpejtë e të suksesshme në përmbushjen e misioneve nga FA. Gatishmëria arrihet përmes organizimit, planizimit dhe stërvitjes në përgjigje të kërkesave të misionit. Angazhimi dhe stërvitja e FA-së gjatë kohës së paqes me forcat ushtarake të vendeve të tjera (në kuadrin e NATO/PfP, Kartës së Adriatik-3, dypalëshe) është me rëndësi për sigurimin e aftësive operacionale për një përgjigje të shpejtë. Ato bashkëveprojnë me organet e pushtetit vendor e qendror, si dhe angazhohen në stërvitjet e operacionet në mbështetje të paqes, të drejtuara nga NATO-ja e BE.

**Të zhdërvjellëta / të përshtatshme.** Zhvillimi në kohë paqeje i FA-së synon krijimin e një force ushtarake të zhdërvjellët dhe të përshtatshme, në përputhje me shumëllojshmërinë e misioneve. Kjo zhdërvjellësi nënkupton aftësinë për të organizuar e manovruar grupime forcash ose reparte të përforcuara, që kombinohen në funksion të situatës së ndryshuar me synim plotësimin e misionit.

**Të qëndrueshme.** Forcat e Armatosura duhet të jenë të qëndrueshme për realizimin e misioneve të tyre. Forcat mbështetëse dhe ato logjistike, si dhe infrastruktura e duhur janë me rëndësi vendimtare për aftësimin e forcave në kohë paqeje, në realizimin detyrave të tyre në përgjigje të situatës së kërkuar. Ato zhvillojnë e mirëmbajnë një infrastrukturë të përshtatshme, si dhe mbështetje logjistike të pandërprerë.

#### **Të afta për mbështetje ushtarake të strukturave civile.**

Forcat e Armatosura duhet të jenë të afta për të përshtatur dhe përdorur formacione ushtarake për të mbështetur strukturat civile të vendit gjatë menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe njerëzore (përmytjet, tërmetet, zjarret etj). Për këtë qëllim Forcat e Armatosura stërviten për zhvillimin dhe përshtatjen e kapaciteteve të tyre për misionet e mbrojtjes civile.

**Forca të organizuara për realizimin e detyrave.** Në situata të nevojshme, Shtabi i Përgjithshëm krijon grupim forcash (Task-force) nga njësitë e FA-së për përballimin e detyrave të veçanta. Krijimi i tyre bazohet në parimet e racionalitetit, mjaftueshmërisë, autonomisë së veprimit, forcës së bashkuar, si dhe bashkëveprimit me agjenci të tjera.

**Forca për operacione speciale.** Në përbërje të strukturave të forcave janë dhe formacione të tjera të pajisura dhe të stërvitura posaçërisht për operacione speciale. Këto forca janë të afta jo vetëm për të përmbushur detyra ushtarake speciale, por ato kanë një rol të rëndësishëm në luftën kundërterroriste.

**Forcat me aftësi të veçanta** janë struktura të vogla, por të specializuara për shkatërrimin e lëndëve plasëse dhe të municioneve të paplasura, për mbrojtjen e popullatës nga armët e dëmtimit në masë (ADM), për hidrografinë, gjeografinë ushtarake, shërbimin meteorologjik për FA-në etj. Këto forca shërbejnë edhe në interes të ekonomisë së vendit ose institucioneve të tjera të shtetit.

## 1. MISIONI I FORCAVE TË ARMATOSURA

**Misioni i Forcave të Armatosura është sigurimi i pavarësisë së vendit, mbrojtjes së tërësisë territoriale dhe rendit kushtetues.**

Dimensioni i sigurisë në ditët e sotme, ka marrë një shpërndarje të re të instrumenteve të sigurisë kombëtare. Diplomacia dhe ekonomia, si elemente kryesore të shtetit, kanë një rol dhe përgjegjësi për forcimin e sigurisë në vend, në zgjidhjen e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura.

Forcat e Armatosura janë instrumenti ushtarak i shtetit për sigurinë e vendit dhe përbëjnë një nga tre elementet kryesore (së bashku me elementet diplomatike dhe ekonomike) të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

**Forcat e Armatosura** marrin pjesë, gjithashtu, në operacione të shumëllojshme të ndihmës humanitare në raste fatkeqësish brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe në misione ndërkombëtare jashtë vendit (me mandat kushtetues).

## **DETYRAT E FORCAVE TË ARMATOSURA**

### **A. Në kohë paqeje**

Forcat e Armatosura në kohë paqeje kanë për detyrë:

- Sigurimin e gatishmërisë luftarake për mbrojtje.
- Monitorimin dhe vëzhgimin e hapësirës tokësore, ajrore e detare.
- Pjesëmarrjen në operacione të ndihmës humanitare në raste fatkeqësish dhe katastrofash në mjedis, në mbështetje të strukturave civile.
- Luftën kundër terrorizmit.
- Pjesëmarrjen në Operacione të Mbështetjes së Paqes.
- Pjesëmarrjen në operacione bashkëveprimi për sigurinë në kohë paqeje (të bashkuara, dypalëshe, shumëpalëshe, NATO/PfP)
- Parandalimin dhe menaxhimin e mbrojtjes së mjedisit nga veprimtaritë ushtarake.

### **B. Në kohë krizash**

Drejtojnë mbrojtjen e popullatës në rast kërcënimesh, incidentesh, aksidentesh ose fatkeqësish natyrore dhe katastrofash në mjedis.

Ndihmojnë në ruajtjen e rendit kushtetues (nëpërmjet angazhimit në rolin ndihmës ndaj strukturave civile) në luftë kundër trafikut ilegal dhe terrorizmit.

Parandalojnë trafikun ilegal të armëve konvencionale dhe ADM.

Rrisin, sipas kërkesës, shkëmbimin e informacionit me Ministrinë e Rendit Publik dhe me institucionet e tjera.

### **C. Në kohë lufte**

Mbrojnë tërësinë territoriale të vendit.

Rrisin angazhimin e forcave në operacion, ridislokojnë forcat dhe mobilizojnë personel dhe njësi plotësuese.

Ndërmarrin operacione mbrojtëse ndaj kërcënimeve.

Ndalojnë çdo shkelje të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe rivendosin situatën në territorin ose kufirin shtetëror.

Mbrojnë popullsinë e Republikës së Shqipërisë.

Forcat e Armatosura përgatiten për t'i kryer këto misione në kuadrin e një **mbrojtjeje kolektive ose të pavarur**.

Forcat e Armatosura kanë për detyrë, gjithashtu, realizimin e detyrimeve që lindin nga pozicioni i vendit pritës në mbështetje të forcave të NATO-s/koalicionit, të cilat mund të veprojnë, të stërviten ose të kalojnë nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **Forcat e Armatosura në luftën kundër terrorizmit**

Veprimet e Forcave të Armatosura në luftën kundër terrorizmit kërkojnë:

Përshtatjen dhe përdorimin e aftësive të tyre për të zbuluar dhe vepruar në kohë ndaj veprimeve terroriste. Ky është një element thelbësor i sigurisë së Republikës të Shqipërisë, i sigurisë rajonale dhe të NATO-s.

**Zbulimi ushtarak dhe informacioni** (si pjesë aktive e strukturave të zbulimit dhe informacionit të përgjithshëm shtetëror) kanë detyrë të rëndësishme dhe me përgjegjësi në parandalimin e akteve terroriste. Kjo mundëson reagimin e duhur dhe në kohë ndaj tyre.

## **2. KOMANDIM - DREJTIMI NË FORCAT E ARMATOSURA**

**Vendimet strategjike** për çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë merren nga organet legjitime të përcaktuara në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Republika e Shqipërisë ka institucionalizuar në Kushtetutën e saj **kontrollin civil demokratik** mbi FA-në dhe ka ngritur me ligj një sistem komandimi në nivel strategjik me autoritetet e larta civile, ndërsa në nivele operationale dhe taktike komandim-drejtimi realizohet nga autoritetet e larta ushtarake.

**Komandimi dhe drejtimi** i FA-së siguron një drejtim të qartë strategjik, të aftë për t'u përgjigjur në kohë për pjesëmarrjen e tyre në parandalimin e konflikteve, menaxhimin e krizave, drejtimin e operationeve luftarake dhe të operationeve të tjera.

**Kuvendi i Republikës së Shqipërisë** kontrollon veprimtarinë e FA-së dhe përcakton pushtetet dhe autoritetin e komandimit të tyre për kohe paqeje, gjendje të jashtëzakonshme dhe kohë lufte dhe kontrollon veprimtarinë e tyre.

**Presidenti i Republikës së Shqipërisë** është Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në kohë paqeje, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes. Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në kohë lufte drejton FA-në nëpërmjet Komandantit të FA-së.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë miraton strukturën organizative dhe planin e përhapjes strategjike të FA-së; planin e veprimeve të Forcave të Armatosura në kohë paqeje dhe në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme, si dhe miraton vendimet e Komandantit të FA-së për përdorimin në veprimet ushtarake në kohë lufte të FA-së.

**Kryeministri** është përgjegjës për drejtimin, zhvillimin dhe gjendjen e Forcave të Armatosura në kohë paqeje.

**Ministri i Mbrojtjes** është përgjegjës para Kuvendit, Presidentit dhe Kryeministrit për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të mbrojtjes.

**Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura** është përgjegjës para Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes për përgatitjen dhe gatishmërinë luftarake të FA-së, për plotësimin me personel, si dhe drejtimin e organizimit e veprimeve ushtarake dhe joushtarake.

**Komandantët e llojeve të forcave** janë drejtuesit ushtarakë më të lartë për Forcat Tokësore, Forcat Detare dhe Forcat Ajrore dhe janë përgjegjës për gatishmërinë operationale për forcat e tyre përkatëse.

### 3. ZHVILLIMI I FORCAVE TË ARMATOSURA

Zhvillimi i FA-së është përgjegjësi e udhëheqjes së lartë civile dhe ushtarake, e cila mbështetet në objektivat dhe parimet e Politikës së Mbrojtjes, për zhvillimin e një force ushtarake të aftë për të garantuar mbrojtjen e vendit.

Forcat e Armatosura përgatiten dhe modernizohen sipas misionit dhe detyrave të përcaktuara në Politikën e Mbrojtjes.

Transformimi dhe modernizimi i Forcave të Armatosura mbështeten në mendimin ushtarak dhe në teknologjinë e kohës, në standardet e NATO-s, në ndërveprueshmërinë dhe zhvillimin e forcave të zhdërvjellëta e të përshtatshme, në parimet e vlerësimit të cilësisë dhe mbajtjen e personelit, si dhe në transparencën e FA-së ndaj shoqërisë civile të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve partnere.

### 4. MISIONI, STRUKTURAT DHE DETYRAT E LLOJEVE TË FORCAVE DHE KOMANDAT MBËSHTETËSE

Forcat e Armatosura përbëhen nga :

#### A. Tre lloje forcash



- Forcat Tokësore (FT)
- Forcat Detare (FD)
- Forcat Ajrore (FAj)

#### B. Dy komanda mbështetëse



- Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes (KDS)
- Komanda e Mbështetjes Logjistike (KML).

**Shtabi i Përgjithshëm** është shtab i bashkuar i Forcave të Armatosura, që funksionon sipas standardeve të NATO-s.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga përbërësit aktivë dhe rezervistë.

Sasia e autorizuar e personelit aktiv të kohës së paqes në bazë të strukturës së **Forcës së Ardhshme 2010** është rreth 14500 ushtarakë aktivë dhe rreth 2000 civilë.

Përbërësi aktiv i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të mbështetet nga një forcë e duhur dhe e arsyeshme rezerviste deri në 10000 veta.

#### A. FORCAT TOKËSORE (FT)

##### Misioni

Forcat Tokësore kanë për mision mbrojtjen e sovranitetit, të tërësisë territoriale të vendit, të popullsisë, si dhe ruajtjen e rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë në bashkëveprim me Forcat Ajrore, Forcat Detare dhe Komandat Mbështetëse.

Forcat Tokësore mbështesin strukturat civile për mbrojtjen e popullsisë në përballimin e fatkeqësive natyrore, si dhe realizojnë operacione bashkëveprimi për sigurinë në kohë paqeje (me institucionet e tjera të shtetit, në kuadrin dypalësh dhe shumëpalësh, me NATO-n, vendet partnere dhe në kuadër koalicioni).

#### **Koncepti operacional**

Koncepti operacional përcakton mënyrën se si **organizohen, pajisen dhe stërviten** Forcat Tokësore për të arritur gatishmërinë operationale dhe përgjigjen e shpejtë ndaj detyrave për mbrojtjen territoriale dhe të popullsisë, përfshirë mbështetjen ndaj strukturave civile për menaxhimin e situatave dhe të kërcënimeve jotradicionale (fatkeqësitë natyrore, terrorizmi), si dhe aftësinë për të dislokuar njësitë e gatshme për veprime të përbashkëta e të ndërveprueshme për operacione të udhëhequra nga NATO-ja ose koalicioni.

#### **Forcat Tokësore, për realizimin e misionit, zbatojnë këto detyra:**

- Kryerjen e vëzhgimit, të zbulimit dhe të analizës për të paralajmëruar në kohë për kërcënimet dhe rreziqet e mundshme ushtarake e joushtarake ndaj vendit.

- Sigurimin e gatishmërisë për t'iu përgjigjur me shpejtësi kërcënimeve ndaj tërësisë territoriale dhe kufijve të Republikës së Shqipërisë, duke bashkëvepruar me forcat dhe institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë (Policia Kufitare etj.), si dhe me forcat e NATO-s.

- Sigurimin e forcave të përgatitura e të afta, si dhe infrastrukturës e mjediseve mbështetëse për ndihmën ushtarake ndaj strukturave civile në operacione humanitare në rast fatkeqësish mjedisore (brenda dhe jashtë vendit) dhe për operacione të mbështetjes së paqes.

- Transformimin dhe modernizimin e FT-së për të rritur aftësitë e tyre operationale, të afta për t'iu përgjigjur me shpejtësi situatave, si dhe të dislokueshme për të kontribuar në operacione të NATO-s dhe në kuadër koalicioni.

#### **Struktura e Forcës**

Forcat Tokësore përbëhen nga: Komanda dhe Shtabi i Forcës, Brigada e Reagimit të Shpejtë (BrRSH), Regjimenti Komando, Brigada e Xhenios, Batalioni i Ndërlidhjes, reparte të tjera mbështetëse, si dhe nga njësi rezerviste të këmbësorisë.

**Brigada e Reagimit të Shpejtë** është njësi bazë e FT-së, e cila plotësohet me përparësi me personel e pajisje, për të siguruar aftësi operationale të plota.

**Regjimenti Komando** është njësi speciale që kryen detyra të një spektri të gjerë të karakterit mbrojtës, mësymës, humanitar, për Operacione të Mbështetjes së Paqes (PSO), në mbështetje të ruajtjes së rendit kushtetues etj.

**Forcat rezerviste** janë komponent i Forcave të Armatosura në përbërje të strukturës së Forcave Tokësore. Kjo strukturë do të ketë edhe njësi rezerviste kuadër (me personel aktiv të kufizuar), të cilat do të kenë pajisje, mjete dhe materiale, sipas tabelave të organizimit dhe të pajisjeve (TOP).

Mobilizimi dhe thirrja e tyre bëhen në mënyrë të planifikuar, graduale, që në kohë paqeje për nevoja stërvitore dhe operationale (humanitare, të sigurisë etj.), në përputhje me mundësitë e mbështetjes financiare.

Për të zbatuar objektivat e Strategjisë Ushtarake, Forcat Tokësore kanë në përbërje të tyre njësi dhe nënreparte tokësore, me gatishmëri të lartë, të dislokueshme dhe të ndërveprueshme.

#### **Infrastruktura**

Garnizonet kryesore të FT janë përqendruar kryesisht në rajonet : Zall-Herr, Vau i Dejës, Poshnjë, Yzberisht etj.

## **B. FORCAT DETARE (FD)**

### **Misioni**

Forcat Detare kanë për mision ruajtjen e tërësisë territoriale detare të Republikës së Shqipërisë në bashkëveprim me Forcat Tokësore, Forcat Ajrore dhe Komandat Mbështetëse, si dhe zbatimin e ligjshmërisë në det.

Forcat Detare realizojnë operacione mbrojtëse të bashkuara me forcat e tjera, detyra sipas ligjit të Rojës Bregdetare, operacione të kërkim-shpëtimit në bashkëveprim me shërbimin e kërkim-shpëtimit (SAR) të Forcave të Armatosura në hapësirën e tyre të përgjegjësisë, si dhe kryejnë operacione humanitare dhe marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit në det.

Republika e Shqipërisë me një vijë bregdetare prej 362 kilometrash dhe pozicion bregdetar strategjik në lidhje me Detin Adriatik e Jon, Kanalin e Otrantos dhe Detin Mesdhe, mundëson zhvillimin e tregtisë detare, të turizmit, peshkimit etj., por, njëherazi, mbart mundësi për akte terroriste, trafikim ilegal të drogës, njerëzve dhe mallrave.

### **Koncepti operacional**

Koncepti operacional përcakton mënyrën se si **organizohen, pajisen dhe stërviten** Forcat Detare për të arritur gatishmëri operacionale dhe përgjigjen e shpejtë ndaj detyrave për ruajtjen e tërësisë territoriale detare. Ai siguron bazën për përdorimin e FD në realizimin e misionit të tyre.

Në parimet e konceptit operacional përfshihen: përgjegjshmëria e interesave të Republikës së Shqipërisë në det, përmirësimi i aftësive operacionale, krijimi i një sistemi informimi për hapësirën detare, përgatitja për operacione ushtarake dhe joushtarake, si dhe forcimi i bashkëveprimit me institucionet e Republikës së Shqipërisë, me forca të tjera jashtë vendit në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe, shumëpalëshe dhe me forcat e NATO-s.

Ky koncept bazohet në përhapjen e përparuar e të vazhdueshme të anijeve patrulluese nëpërmjet rotacionit të tyre nga të dy bazat kryesore në katër bazat ndihmëse, duke siguruar në çdo kohë një minimum prej katër mjetesh lundrimi të gatshme jashtë bazave.

Plani i zhvillimit të FD siguron kuadrin e përgjithshëm për transformimin dhe modernizimin e forcës, si një plan integrimi të tyre në arritjen e standardeve të kërkuara.

### **Forcat Detare, për realizimin e misionit, zbatojnë këto detyra:**

- **Vëzhgimin bregdetar.** Sigurimi i paralajmërimit dhe i vëzhgimit të ujërave dhe bregdetit, monitorimin dhe kontrollin e lëvizjeve brenda ujërave territoriale.

- **Gatishmërinë për mbrojtje.** Sigurimi i kundërveprimit të shpejtë ndaj shkeljeve të ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë në bashkëveprim me Forcat Tokësore dhe Forcat Ajrore.

- **Kërkim-shpëtimin.** Drejtimi dhe organizimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit në ujërat territoriale të RSH.

- **Ndalimin e trafikimit.** Ndalimi i kalimit ilegal të emigrantëve, drogës dhe mallrave, nëpërmjet operacioneve për zbatimin e ligjshmërisë në det.

- **Mbrojtjen e mjedisit.** Pengimi dhe kundërveprimi ndaj incidenteve për ndotjen e mjedisit në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë e gjatë vijës bregdetare.

- **Sigurimin e lundrimit në det.** Hidrografia dhe ndihma për lundrim, sigurimi detar dhe kontrolli i transportit/dokumentacionit detar.

- **Operacionet për bashkëpunimin dhe sigurinë në kohë paqeje të jenë:** të bashkuara, dypalëshe, shumëpalëshe, si dhe operacione në kuadrin e NATO/PfP-së, të Adriatik-3 dhe të Bashkimit Europian.

### **Struktura e forcës**

Forcat Detare përbëhen nga: Komanda dhe Shtabi; dy distrikte detare; një batalion logjistik (mirëmbajtje-riparim), njësi e vëzhgimit të hapësirës detare; kantieri i riparimit të anijeve, si dhe elemente të tjera mbështetëse.

### **Infrastruktura.**

Garnizonet kryesore të Forcave Detare janë përqendruar kryesisht në rajonet Durrës dhe Vlorë.

Forcat Detare veprojnë në dy baza detare kryesore në Bishtin e Pallës, Durrës dhe Pashaliman në Vlorë, si dhe në katër baza ndihmëse dhe rezervë përkatësisht në Shëngjin, Palermo, Sarandë dhe Sazan.

Elementet ndihmëse përfshijnë mjediset për riparim e mirëmbajtje të Kantierit Detar, Shkollën e Trupës, një batalionin logjistik dhe Shërbimin Hidrografik të Forcave Detare.

## **C. FORCAT AJRORE (FAj)**

### **Misioni**

Forcat Ajrore kanë për mision ruajtjen e sovranitetit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet operacioneve ajrore dhe kundërajrore (të mbrojtjes ajrore) me forcat e veta dhe në bashkëveprim me forcat e tjera.

### **Koncepti operacional**

Koncepti operacional përcakton mënyrën se si **organizohen, pajisen dhe stërviten Forcat Ajrore për të arritur** gatishmërinë operacionale dhe përgjigjen e shpejtë ndaj detyrave për ruajtjen e hapësirës ajrore. Ai siguron bazën për përdorimin e Forcave Ajrore në realizimin e misionit të tyre.

Në parimet e konceptit operacional përfshihen: përmirësimi i aftësive operacionale për të siguruar monitorimin dhe kontrollin e hapësirës ajrore; mbrojtja ajrore e palëvizshme e objekteve më të rëndësishme strategjike; mbështetja me mbulim ajror dhe transportim trupash në operacione të Forcave të Armatosura, pjesëmarrja në operacionet humanitare, si dhe në operacionet kombëtare të kërkim-shpëtimit.

### **Për realizimin e misionit kërkohet të zhvillohet:**

**Mbrojtje ajrore me sisteme të lëvizshme** për të mbuluar forcat në fushën e luftimit, si dhe mbrojtje ajrore me sisteme të palëvizshme për të mbuluar objektet kryesore strategjike të Republikës së Shqipërisë.

**Kontroll i hapësirës ajrore** nga qendra e kontrollit ajror të pajisur me radarë që mbulojnë gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë që, sipas nevojës, të kenë si detyrë plotësimin e tablosë ajrore të NATO-s.

**Mbështetja e FT dhe e FD me helikopterë** për transport trupash dhe me aeroplanë për detyra vëzhgimi, të pajisur me mjete për operacione zbulimi dhe kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

**Mbështetja me shërbim meteorologjik** të Forcave Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

### **Forcat Ajrore, për realizimin e misionit, zbatojnë këto detyra:**

- Monitorim dhe kontroll të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

- Paralajmërim në kohë i kërcënimit ajror.

- Kundërveprim ndaj shkeljeve të hapësirës ajrore.

- Sigurim të objekteve të rëndësishme së veçantë me mbulim ajror.

- Mbështetje të afërt me transport trupash dhe zjarr të veprimeve luftarake të Forcave

Tokësore dhe Forcave Detare.

Kryerje të operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë dhe të kërkim-shpëtimit.

Ndihma në kuadrin e bashkëpunimit me vendet e NATO-s për përmbushjen e detyrave të vëzhgimit dhe të mbrojtjes ajrore është shumë e rëndësishme për Forcat Ajrore në zbatim të misionit dhe planit specifik të modernizimit të tyre.

### **Struktura e Forcës**

Forcat Ajrore përbëhen nga: Komanda dhe Shtabi, një regjiment me helikopterë shumëpërdorimësh, një brigadë të mbrojtjes ajrore me sisteme të lëvizshme dhe të palëvizshme, Shkolla e Trupës, si dhe njësitë e tjera mbështetëse.

### **Infrastruktura**

Garnizonet kryesore të Forcave Ajrore janë përqendruar kryesisht në bazat kryesore në Rinas dhe Farkë, si dhe në dy bazat rezervë në Kuçovë dhe Gjadër.

## **D. KOMANDA E DOKTRINËS DHE E STËRVITJES (KDS)**

Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes është një komandë mbështetëse e Forcave të Armatosura.

### **Misioni**

Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes ka për mision arsimimin, stërvitjen, kualifikimin e ushtarëve, studentëve, nënoficerëve, oficerëve dhe personelit civil të Forcave të Armatosura.

Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes zhvillon dhe përsos mendimin ushtarak në Forcat e Armatosura, nëpërmjet dokumenteve me karakter rregullues dhe doktrinor. Ajo zhvillon dhe sinkronizon konceptet doktrimore bazë për organizimin, përdorimin dhe operacionet e FA-së në përputhje me Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Shqipërisë, Strategjinë Ushtarake dhe me konceptet e standardet e NATO-s.

### **Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes, për realizimin e misionit, zbaton këto detyra:**

- Drejton punën studimore-kërkimore për problemet në fushat e politikës së mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe në përpunimin e mëtejshëm të Strategjisë Ushtarake.
- Harton Doktrinën e Bashkuar të FA-së dhe doktrinën e tjera.
- Harton doktrinën për përgatitjen ushtarake të FA-së (stërvitjen individuale dhe kolektive).
- Përgatit dhe drejton programet e arsimimit për oficerët dhe nënoficerët e FA.
- Përgatit dhe drejton programet për stërvitjen e ushtarëve profesionistë dhe stërvitjen bazë për të gjitha kontingjentet e FA.
- Përgatit dhe drejton programet për trajnimin, përparimin në gradë të oficerëve dhe nënoficerëve të FA.
- Harton dhe publikon historinë ushtarake të popullit shqiptar dhe të FA, si dhe publikon historitë ushtarake të vendeve të tjera.
- Harton dhe publikon fjalorët enciklopedikë dhe terminologjikë në fushën e mbrojtjes.
- Organizon dhe drejton kurset ushtarake të përparuar.

### **Struktura e Komandës**

Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes përbëhet nga: Komanda dhe Shtabi, Akademia e Mbrojtjes, Universiteti Ushtarak "Skënderbej", Akademia e Nënoficerëve, Brigada e Stërvitjes Bazë, Batalioni i Mbështetjes Logjistike dhe qendrat e kërkimeve shkencore ushtarake.

### **Infrastruktura**

Garnizonet kryesore të KDS janë të përqendruara në Tiranë dhe Vlorë.

## **E. KOMANDA E MBËSHTETJES LOGJISTIKE (KML)**

### **Misioni**

Komanda e Mbështetjes Logjistike është komandë mbështetëse e FA-së, e cila **ka si mision kryesor** mbështetjen e FA-së në fushat e prokurimit dhe furnizimit, të mirëmbajtjes, të transportit, të sigurimit të shërbimit të intendencës, të furnizimit shëndetësor, si dhe mbështetjen e bashkëpunimit civilo-ushtarak për këto çështje. KML dhe njësitë e repartet e mbështetjes logjistike të forcave duhet të jenë në gjendje të përmbushin të gjitha kërkesat për të mundësuar qëndrueshmërinë logjistike në operacionet e forcave në çdo lloj mjedisi.

### **Koncepti operacional**

Komanda e Mbështetjes Logjistike përshtat kapacitetet operacionale, sipas nevojave, për të mbështetur objektivat e Strategjisë Ushtarake me anë të përcaktimit të përparësive të nevojshme për të siguruar mbështetje të forcave në kohën dhe në masën e duhur.

Për të mbështetur Forcat e Armatosura në kohë paqeje, krize ose lufte KML ka reparte të lëvizshme dhe kapacitete për të mbështetur pjesëmarrjen e FA-së në plotësimin e misioneve, duke përfshirë angazhimet dypalëshe, shumëpalëshe dhe me forcat e NATO-s.

Sistemi logjistik zhvillohet dhe modernizohet duke pasur parasysh **detyrat** dhe **objektivat** e mëposhtëm:

- Zbatimin e strukturave modulare (të përbëra nga pjesë të veçanta) për mbështetjen logjistike të përqendruar e të integruar të strukturave operacionale (forcat e dislokuara, forcat e reagimit ndaj krizave, forcat kryesore dhe forcat rezerviste).

- Ngritjen e strukturave të mbështetjes logjistike, me kapacitet për të ndërvepruar me sistemet logjistike të Forcave të Armatosura të vendeve të NATO-s.

- Arritjen e një shkalle të lartë të efektshmërisë nëpërmjet lëvizjes dhe kapacitetit të forcave modulare, që të përshtaten me detyrat e forcave të ndryshme.

- Realizimin e një planizimi të përqendruar dhe ekzekutimi të decentralizuar, me synim që të sigurojë mbështetjen e nevojshme logjistike gjatë zhvillimit të operacionit të planizuar brenda dhe jashtë territorit të vendit në operacionet shumëkombëshe.

- Zhvillimin e përpunimit automatik të sistemeve të të dhënave logjistike.

- Shmangien e detyrave paralele dhe të dublimeve me forca dhe komanda të ndryshme.

- Angazhimin e burimeve civile, me qëllim që të ndihmohet plotësimi i detyrave të strukturave logjistike, duke përfshirë rastet kur angazhimi ka përfitime ekonomike.

### **Struktura**

Komanda e Mbështetjes Logjistike përbëhet nga: Komanda dhe Shtabi, një brigadë furnizimi, një brigadë transporti, një bazë logjistike mirëmbajtjeje, Spitali Ushtarak Qendror Universitar, një qendër për riparimin kapital (mirëmbajtje e nivelit IV), si dhe struktura të tjera mbështetëse.

### **Infrastruktura**

Njësitë dhe repartet e KML janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbështesin veprimet e FA-së. Infrastruktura e KML siguron mbështetjen e FA-së në gjithë territorin për realizimin e misionit të tyre.

## **F. NJËSITË DHE REPARTET AUTONOME TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA**

**Shtabi i Përgjithshëm ka në varësi të drejtpërdrejtë, këto njësi:** Qendrën e Bashkuar Operacionale, Batalionin e Ndërlidhjes, Batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, Batalionin e Policisë Ushtarake, Qendrën e Radiozbulimit, Bazën e Mbrojtjes Civile, si dhe njësi të tjera mbështetëse.

**Struktura e shërbimit të kërkim-shpëtimit** është organizuar në mënyrë të përqendruar në Qendrën e Bashkuar Operacionale dhe me elementë të tjerë në Forcat Ajrore, Detare dhe Tokësore.

## **5. ELEMENTET BAZË TË MBROJTJES**

### **A Burimet njerëzore**

Konsolidimi i sistemit të përgjithshëm të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përkujdesja ndaj personelit mbetet një detyrë parësore për secilën strukturë të Forcave të Armatosura. Ky sistem është themelor për tërheqjen, përgatitjen dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit, sipas standardeve të NATO-s.

Zbatimi i planeve për arsimimin dhe trajnimin afatgjatë të oficerëve dhe nënoficerëve siguron aftësimin profesional gjithnjë në rritje të personelit të FA. Rol parësor ka zhvillimi i trupës së nënoficerëve të karrierës dhe plotësimi i TOP me ushtarë profesionistë.

Rekrutimi i personelit të FA-së dhe mobilizimi i forcave rezerviste realizohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nga organizmat e përcaktuar për këtë detyrë. Ky sistem do të sigurojë mobilizim të pjesshëm në raste tensionesh ose krizash dhe mobilizim të plotë në rast lufte. Ngritja e këtij sistemi do të bazohet në plane afatmesme dhe afatgjata të vënies së tyre në gatishmëri.

Strukturat e qeverisjes vendore përfshihen, gjithashtu, në menaxhimin e këtij sistemi.

### **B. Arsimiti dhe stërvitja në Forcat e Armatosura**

Koncepti i përgjithshëm i arsimimit në FA është i lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e aftësive operacionale në FA. Elementet e konceptit të përgjithshëm janë:

- Arsimiti i ushtarëve të shërbimit të detyrueshëm dhe profesional, i nënoficerëve dhe oficerëve, i personelit të karrierës ushtarake të të gjitha niveleve të drejtimit për t'i aftësuar ata në realizimin e detyrave të përcaktuara.

- Formimi i gjithë personelit të FA, për ta bërë të vetëdijshëm për rolin që ka në realizimin e misionit të FA.

- Arsimiti i përparuar për personelin e karrierës, duke e çuar atë drejt një vetëdije dhe motivimi më të lartë për plotësimin e detyrave.

- Kualifikimi i drejtuesve për të plotësuar të gjitha nivelet e drejtimit në Forcat e Armatosura.

- Zhvillimi i stërvitjes reale si element i qenësishëm dhe i njësuar në të gjitha njësitë dhe repartet e FA, për të siguruar gatishmëri operacionale, sipas standardeve të NATO-s.

**Sistemi i arsimimit dhe i stërvitjes** organizohet dhe funksionon në përputhje me konceptet e përgjithshme të arsimimit në FA. Këto koncepte zhvillohen në Akademinë e Mbrojtjes, në Universitetin Ushtarak "Skënderbej", në shkollat e trupës, në Qendrën e Stërvitjes Bazë dhe në Akademinë e Nënoficerëve.

Sistemi arsimor në FA realizon përgatitjen për një spektër të gjerë të misioneve të pritshme – gatishmëri për mbrojtje, mbështetje ushtarake ndaj strukturave civile, si dhe pjesëmarrje në operacione të mbështetjes së paqes. Qëllimi kryesor i arsimimit dhe i stërvitjes në FA është krijimi i aftësive operacionale të qëndrueshme për të siguruar gatishmëri të lartë në përgjigje të situatave në kohë paqeje, krize apo lufte.

### **Përgatitja e trupave, e komandave dhe e shtabeve**

Përgatitja e trupave, e komandave dhe e shtabeve synon rritjen e aftësive operacionale të FA-së për të zbatuar objektivat e SU-së.

Përgatitja fillon me rritjen cilësore të kualifikimit profesional të oficerëve dhe nënoficerëve, rritjen e aftësive të tyre si drejtues në çdo nivel komandimi. Përgatitja dhe rritja cilësore e shtabeve është domosdoshmëri për përgatitjen e lartë të njërive.

Përgatitja e njësisë përfshin stërvitjen e strukturave vartëse të saj deri në nivel skuadre dhe toge, me synim, që njësitë (repartet) të kryejnë detyrat e tyre.

Bazë për përcaktimin e aftësive operacionale të njërive është përmbushja e listës së detyrave të misionit të saj në kohë paqeje, krize dhe lufte. Këtu fillon dhe planizimi i komandave për përgatitjen e njërive.

Shtabet eprore ndihmojnë dhe marrin pjesë në procesin stërvitor, duke bërë të mundur që çdo formacion i vogël, shtab taktik dhe shtab operacional të përgatitet plotësisht dhe të aftësohet për të përmbushur misionin.

Përqendrimi i strukturave të njërive luftarake është proces vendimtar në sigurimin e rezultateve të larta në përgatitjen dhe stërvitjen e tyre. Shfrytëzimi i infrastrukturës së përmirësuar për stërvitje, mbështetja nga komandat eprore në procesin stërvitor dhe efektiviteti i komandim-drejtimin do të mundësojnë sigurimin e aftësive të larta operacionale.

Stërvitjet të zhvillohen në nivel të lartë sipas praktikave, standardeve dhe procedurave të vendeve të NATO-s, në përputhje me konceptin e aftësive operacionale. Përgatitja të zhvillohet e bashkuar, e kombinuar me llojet e tjera të armëve dhe shërbimeve atje ku është e mundshme, si dhe e përbashkët.

Informatizimi të jetë një kërkesë në rritje për zhvillimin e stërvitjeve në të gjitha nivelet e komandave dhe të shtabeve. Kjo mundëson që të gjitha njësitë luftarake të mësojnë të punojnë dhe të veprojnë së bashku me elementët e mbështetjes përfshirë dhe forcat e shërbimeve të tjera. Në planin e stërvitjes të përfshihet në përfundim vlerësimi, duke u pasqyruar në një raport kritik të zhvillimit dhe të arritjeve të saj. Ky përbën një hap të domosdoshëm në sigurimin e cilësisë së përgatitjes për arritjen e objektivave të saj.

### C. Infrastruktura

Infrastruktura e FA-së zhvillohet dhe modernizohet në mbështetje të strukturës dhe në misionet e reja të forcave dhe të njësisë, për të rritur nivelin e stërvitjes, standardet e jetesës së personelit, si dhe zhvillimin e saj në fushat më të qenësishme, për të përmbushur detyrat në kuadrin dypalësh dhe shumëpalësh.

Investimet në infrastrukturë, veçanërisht në bazat detare dhe ajrore, në poligonet kombëtare, kanë si synim plotësimin e standardeve të kërkuara për të qenë të gatshme dhe në dispozicion për forcat e NATO-s.

Zhvillimi i infrastrukturës kombëtare merr në konsideratë përdorimin e saj nga FA, ashtu si dhe realizimin e detyrimeve që lindin nga pozicioni i vendit pritës në mbështetje të forcave të NATO-s/koalicionit, të cilat mund të veprojnë, të stërviten ose të kalojnë nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë.

Infrastruktura, që del tepër sipas planit të përhapjes strategjike dhe është e panevojshme për FA-në, do të eliminohet sipas një plani të përcaktuar. Shndërrimi dhe përmirësimi i sistemit të mirëmbajtjes zhvillohet në përgjigje të nevojave që kanë Forcat e Armatosura për prodhime dhe mirëmbajtje.

### D. Mbështetja financiare e Forcave të Armatosura

Për vazhdimin e programit të mbrojtjes, transformimin dhe modernizimin e FA, sipas objektivave të kësaj strategjie, do të synohet **një rritje progresive vjetore** e buxhetit të mbrojtjes **prej 0,1 % të PBB-së, për arritjen e tij në vitin 2010, 2% të PBB-së** në përputhje me treguesit e zhvillimit ekonomik të vendit.

Fondi i modernizimit të Forcave të Armatosura do të jetë zë i veçantë brenda Buxhetit të Shtetit.

Programet e ristrukturimit dhe të modernizimit përmirësohen dhe përshtaten mbi bazën e realitetit fiskal aktual për vitet e planifikuara. Procesi efektiv i vendimmarrjes, sistemet dhe metodat bashkëkohore të menaxhimit të burimeve, ndihmojnë institucionin e mbrojtjes për të menaxhuar efektivisht burimet e dhëna për marrjen e vendimeve të duhura, në mënyrë që të mbështeten objektivat e Strategjisë Ushtarake.

### Përparësitë për transformimin dhe modernizimin e FA-së janë:

- Rritja e gatishmërisë operacionale për mision. Forcat e Armatosura do të përqendrohen në stërvitjen e forcave aktive, të afta për të plotësuar misionet e tyre, sipas standardeve të NATO-s, duke përfshirë njësi e reparte të zgjedhura të reagimit të shpejtë dhe në operacionet me dislokime të përparuar e të ndërveprueshme me forcat e NATO-s/koalicionit.
- Modernizimi/zëvendësimi i pajisjeve sa më shpejt që të jetë e mundur brenda kufizimeve financiare.
- Riorganizimi i FA-së sipas standardeve për realizimin e misionit dhe të detyrave të përcaktuara në Strategjinë Ushtarake

Elemente të tjera parësore për transformimin dhe modernizimin e FA-së janë: konsolidimi i sistemit të planifikimit, programimit dhe buxhetimit, i cili tani është zbatuar në strukturat dhe njësitë e Forcave të Armatosura; vendosja e sistemit C4; kompletimi me helikopterë dhe anije të shërbimit SAR; kompletimi me mjete kryesore të transportit tokësor të strukturave parësore të Forcave të Armatosura.

### **PËRFUNDIME**

Dokumenti i Strategjisë Ushtarake përshkruan objektivat, parimet, konceptet dhe karakteristikat e Forcave të Armatosura.

Strategjia Ushtarake e Forcave të Armatosura siguron një përmbledhje të misioneve të përgjithshme të FA-së, si dhe përshkruan procedurat për zhvillimin e tyre.

Në këtë dokument jepet struktura komanduese e FA-së dhe bëhet përshkrimi i llojeve të forcave dhe komandave mbështetëse (përfshirë misionet, strukturat, infrastrukturën, konceptin operacional dhe detyrat për çdo lloj force). Aty trajtohen probleme të rëndësishme për Forcat e Armatosura si: burimet njerëzore, koncepti i arsimimit dhe i stërvitjes, infrastruktura, burimet financiare dhe modernizimi, duke përcaktuar përparësitë e përgjithshme për planifikimin e tyre.

#### **Shkurtesat:**

- Republika e Shqipërisë (RSH)
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare (SSK)
- Strategjia Ushtarake (SU)
- Forcat e Armatosura (FA)
- Forcat Tokësore (FT)
- Forcat Detare (FD)
- Forcat Ajrore (FAj)
- Komanda e Doktrinës dhe e Stërvitjes (KDS)
- Komanda e Mbështetjes Logjistike (KML)
- Komandim, Kontroll, Komunikim, Kompjuter (Command, Control, Communication and Computerisation) (C4)
- Tabela e Organizimit dhe e Pajisjeve (TOP)
- Armët e Dëmtimit në Masë (ADM)
- Shërbimi i Kërkim- Shpëtimit (Searching and Rescuing) (SAR)
- Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)
- Bashkimi Europian (BE)
- Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO)
- Programi i Partneritetit për Paqe (Partnership for Peace) (PfP)
- Plani i Veprimtimit për Anëtarësim (Membership Action Plan) (MAP)
- Programi Individual i Partneritetit (Individual Partnership Program) (IPP)
- Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Partneritetit (Planning and Reviewing Process) (PARP)
- Operacionet e Mbështetjes së Paqes (Peace Support Operations) (PSO)
- Karta e Adriatik-3 (A-3)
- Brigada Shumëkombëshe e Europës Juglindore (South Eastern European Brigade) (SEEBRIG)

**LIGJ**  
**Nr. 9420, datë 20.5.2005**

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE TË  
DETYRUESHME SHOQËRORE TË PAPAGUARA**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Falen kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore, të papaguara deri në datën 31.12.2004, nga ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital tërësisht shtetëror, nga institucionet shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, nga ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital të përbashkët me shtetin, nga personat juridikë e fizikë privatë dhe nga personat e vetëpunësuar në bujqësi, me kusht që detyrimet për kontributet të arkëtohen brenda datës 31.12.2005.

Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 2**

Pushohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për pjesën e kamatëvonesave të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore të papaguara, të cilat falen me këtë ligj.

**Neni 3**

Kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4625, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI:**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**  
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**

Doli nga shtypi më 14.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë